



Planina / Dorezuar Punëno/Prodato Rectory/Delivery		15.04	1	viti god year
Organ /Njësia Org/Unit	Nr Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHIK	1795/2021		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.200/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.200/2021 të datës 29.03.2021 të parashtruar nga ankuesi më adresë Rr. "Gjemajl Ademi" pn, në Viti, kundër organit të punësimit Komunes së Vitisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.200/2021 e datës 29.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Vitisë, me datë 25.03.2021 përmes postes ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1452/2021 të regjistruar me numër A.nr.200/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Vitisë. Këshilli me datë 13.04.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1452/2021 të regjistruar me numër A.nr.200/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 30.12.2020 për kompensim të shpenzimeve të ushqimit drejtuar Kryetarit të Komunës së Vitisë; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.02.2021 nga Kryetari i Komunës së Vitisë; Ankesën e datës 25.02.2021 të ankuesit e parashtruar në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa; Akt Emërimit të datës 20.12.2011 për ankuesin; Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 10.03.2010; dhe Përgjigjen në ankesë të datës 13.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit të datës 30.12.2011 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Regjistruar Civil" në Komunën e Vitisë, ku i njëjti, me datë 30.12.2020 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Vitisë me kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Kryetari i Komunës së Vitisë përmes shkresës me numër protokoll 02-320/04-43068 të datës 05.02.2021 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij duke e njoftuar ankuesin se nuk është planifikuar buxhet për këtë çështje dhe po ashtu te njëjtin e ka njoftuar se do të insistojmë në vazhdimësi për realizimin e kërkesës së tij.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Kryetarit të Komunës së Vitisë, më datë 25.02.2021 i është drejtuar Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa pranë Komunës së Vitisë, dhe meqenëse nga ky i fundit nuk ka marr përgjigje, i njëjti, me datë 29.03.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime të njëjta ankimore për kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe me nenin 54 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete.* Mirëpo duke u bazuar në dispozitat e nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës është konstatuar se kjo marrëveshje ka qenë në fuqi vetëm tri vite, respektivisht deri me datë 31.12.2017, dhe e njëjta nuk është ripërtëri, kështu



që pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.200/2021

Avdyll BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunes së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

